NDËRTIMI I ELASTICITETIT NDAJ FATKEQËSIVE NË BALLKANIN PERËNDIMOR DHE NË TURQI

C.N. IPA/2012/290-552

UNISDR
The United Nations Office for Disaster Risk Reduction

WMO

PROGRAMI DHE OBJEKTIVAT E TIJ

Në maj të vitit 2012 UNISDR-ja dhe WMO-ja filluan zbatimin e përbashkët të projektit "Ndërtimi i elasticitetit ndaj fatkeqësive në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi" me mbështetjen e Komisionit Evropian (Drejtoria e Përgjithshme për Zgjerimin) nën Ndihmën e Instrumentit të Para-aderimit (IPA). Projekti do të zbatohet në bashkëpunim me agjencitë përkatëse kombëtare përgjegjëse për menaxhimin e rreziqeve ndaj fatkeqësive dhe hidro-meteorologjinë nga vendet përfituese të IPA-s në Evropën Juglindore; Shqipëri, Bosnjë-Hercegovinë, Kroaci, Mali i Zi, Serbi, ish Republika Jugosllave e Maqedonisë dhe Kosova . Projekti bazohet në rezultatet e ndërhyrjeve të mëparshme të realizuara në rajonin përfitues nga organizatat ndërkombëtare, të tilla si WMO-ja, UNDP-ja (me mbështetjen e IPA-s), UNISDR-ja dhe Banka Botërore.

Objektivi i përgjithshëm është ndërtimi i rezistencës së shteteve përfituese të IPA-s ndaj fatkeqësive të shkaktuara nga ndikimi i katastrofave natyrore në përputhje me prioritetet e përcaktuara nga Kuadri i Hyogo-s për Veprim 2005-2015, "Ndërtimi i Shteteve dhe Komuniteteve të Sigurta ndaj Katastrofave" (HFA). Më specifikisht projekti synon të:

- rrisë bashkëpunimin dhe kapacitetin rajonal në zhvillimin dhe zbatimin e masave për uljen e rreziqeve ndaj fatkeqësive;
- trajtojë rreziqet në rritje, të shkaktuara nga ndryshimet klimaterike;
- forcojë bashkëpunimin ndërkufitar për menaxhimin e rreziqeve ndaj fatkeqësive, dhe të
- rrisë kapacitetin kombëtar dhe rajonal për monitorimin dhe parashikimin e kushteve të rrezikshme dhe të bëjë të mundur shkëmbimin e të dhënave dhe produkteve përkatëse për të bërë të mundur një qasje rajonale ndaj uljes së rrezikut nga katastrofat.

Aktivitetet e projektit janë të strukturuara në tetë detyra: katër prej tyre drejtohen nga UNISDR-ja dhe përqendrohen në ndërtimin e kapaciteteve për menaxhimin e rrezikut, menaxhimin e njohurive, kapacitete për transferimin e rreziqeve nga fatkeqësitë (sigurimet për katastrofat) dhe menaxhim fatkeqësish bazuar në komunitet. Katër detyrat e tjera drejtohen nga WMO-ja dhe përqendrohen në vlerësimin e rrezikut, kapacitetet parashikuese meteorologjike dhe hidrologjike, duke bërë të mundur menaxhimin e rreziqeve klimaterike në vendimmarrjen dhe projektimin e një sistemi paralajmërimi të harmonizuar në të gjithë rajonin.

Projekti zgjat 24 muaj dhe përfundon në maj të 2014-ës.

[1]Ky emërtim nuk e cënon pozicionin për statusin dhe është në përputhje me UNSCR 1244/99 dhe me Opinionin e ICJ-së për Deklarimin e Pavarësisë së Kosovës

ZONAT E PERQENDRIMIT

NDERTIMI I KAPACITETEVE PER ULJEN E RREZIQEVE

VENDOSJE NE HARTE DHE ANALIZIM I RREZIQEVE

SHKEMBIMI I TE DHENAVE MBI ULJEN E RREZIQEVE

PARASHIKIM I FENOMENEVE TE RREZIKSHME

TRANSFERIMI I RREZIQEVE NGA FATKEQESITE

MENAXHIM TE RREZIKUT KLIMATERIK DHE ADOPTIM TE NDRYSHIMEVE KLIMATERIKE

REZISTENCE ME BAZE NE KOMUNITET

SISTEM TE PARALAJMERIMIT TE HERSHEM MBI KATASTROFAT

DETYRAT E UNISDR-së

Rritja e kapacitetit dhe koordinimit rajonal institucional për uljen e rreziqeve nga fatkeqësitë dhe adoptimin ndaj ndryshimeve klimaterike

Shkëmbimi i eksperiencave ndërmjet përfituesve të IPA-s dhe vendeve të BE-së ka rëndësi shumë të madhe për rritjen e rezistencës ndaj fatkeqësive natyrore. Aktivitetet nën këtë detyrë nxisin të mësuarit e oficerëve përgjegjës në fushën e parandalimit të fatkeqësive nga njëri-tjetri për t'u përgatitur dhe për të ulur rrezikun. Elementët përkatës të procesit të mësim-nxënies nga përfituesit e IPA-s do të pasqyrohen në një raport përfundimtar.

Forcimi i kapaciteteve dhe bashkëpunimit rajonal lidhur me shkëmbimin e të dhënave dhe të njohurive mbi rreziqet

Ekziston një pasuri e tërë njohurish mbi menaxhimin e rreziqeve nga fatkeqësitë prodhuar në vendet përfituese. Projekti mbështet zhvillimin e një portali në internet, ku do të vihen dokumente, botime dhe informacione në gjuhë të ndryshme për të promovuar shpërndarjen e njohurive për uljen e rreziqeve nga niveli kombëtar në nivel komuniteti.

Promovimi i produkteve të sigurimit dhe risigurimit për transferimin e rreziqeve nga fatkeqësitë ndërmjet përfituesve të IPA-s

Produkte për sigurimin nga fatkeqësitë dhe rreziqet mjedisore për pronarët e shtëpive dhe të ndërmarrjeve të vogla janë të nevojshme për të siguruar mbrojtjen e nevojshme financiare të aseteve dhe të të ardhurave të biznesit në rast fatkeqësish. Projekti kontribuon në rritjen e kapacitetit të përfituesve të IPA-s për sigurimin e rreziqeve nga fatkeqësitë dhe rrit ndërgjegjësimin e publikut të gjerë për këto produkte.

Rritja e ndërgjegjësimit të publikut për reduktimin e rrezikut ndaj fatkeqësive

Rritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve për rreziqet është një element shumë i rëndësishëm i çdo ndërhyrjeje për uljen e rreziqeve. Projekti mbështet aktivitete që synojnë të zhvillojnë një kulturë rreziku ndërmjet komuniteteve që jetojnë në zonat urbane dhe që mbështeten nga "Fushata e Qyteteve të Sigurta" Qyteti im Po bëhet Gati!" në nivelin vendor.

ЗАДАЦИ WMO-A

Rritja e vlerësimit rajonal të rrezikut dhe e kapaciteteve të planifikimit në hartë nëpërmjet përmirësimit të kapaciteteve të përfituesve për analizën e rreziqeve dhe hedhjen e tyre në hartë

Do të bëhen përpjekje për mbështetjen e shpëtimit të të dhënave historike meteorologjike dhe klimaterike, për përmirësimin e sistemeve të menaxhimit të të dhënave klimaterike, dhe për përmirësimin e cilësisë së të dhënave hidrometeorologjike, homogjenizimin dhe standardizimin e tyre. Do të realizohen aktivitete për përmirësimin e analizave të thatësirave dhe hedhjen e tyre në hartë, si dhe për menaxhimin e përmbytjeve të rrezikshme, ku do të përfshihet dhe projekti pilot i Lumit Sava për rritjen e menaxhimi të të dhënave hidrometeorologjike dhe shkëmbimin e procedurave në nivelin e basenit.

Rritja e kapacitetit të përfituesve të IPA-s për parashikimin e fenomeneve të rrezikshme meteorologjike dhe hidrologjike dhe për paralajmërimet në kohë për të mbështetur DRR-në

Aftësitë jo të mira për parashikimin e motit të vendeve përfituese do të përmirësohen në mbështetje të sistemeve të Paralajmërimit të Hershëm nëpërmjet trajnimeve të shpeshta të parashikuesve meteorologjikë dhe hidrologjikë. Qëllimi është çuarja përpara e shkëmbimeve ndërkufitare të të dhënave dhe përmirësimi i cilësisë së të dhënave mbështetëse për uljen e rreziqeve nga katastrofat meteorologjike dhe hidrologjike.

Zhvillimi i kapaciteteve të duhura në mbështetje të menaxhimit të rrezikut klimaterik dhe adoptimin ndaj ndryshimeve klimaterike në programin kombëtar dhe rajonal të DRR-së

Kapacitetet e përfituesve në menaxhimin e rrezikut ndaj thatësirave, përdorimin dhe interpretimin e skenarëve me rreze të gjatë parashikimi dhe aplikimi i vëzhgimit të klimës, do të përmirësohen. Për më tepër, vëmendje do t'i kushtohet zhvillimit dhe ofrimit të shërbimeve dhe produkteve të specializuara në lidhje me menaxhimin e rreziqeve meteorologjike dhe hidrologjike në fushën e sigurimit, si edhe zhvillimit dhe ofrimit të shërbimeve klimaterike për sektorë të ndryshëm të ekonomisë.

Projektimi i sistemeve rajonale të paralajmërimit të hershëm për shumë katastrofa, të përbërë nga sistemet kombëtare të harmonizuara të sistemeve të paralajmërimit brenda kuadrit të bashkëpunimit rajonal

Kjo detyrë do të përqendrohet në projektimin e një sistemi rajonal të paralajmërimit të hershëm për shumë fatkeqësi duke dhënë paralajmërime të sakta, të besueshme dhe të kuptueshme dhe në mënyrë të rregullt mbi organet, operacionet e emergjencës dhe popullsinë në rrezik, për t'u lejuar masave parandaluese të ulin ndikimet e katastrofave të mundshme. Vëmendje do t'i kushtohet katastrofave parësore që prekin rajonin, duke përfshirë dhe zjarret në pyje, valët e nxehta, stuhitë e fuqishme, përmbytjet dhe thatësirën.

Yngve Engström
Drejtoria e Përgjithshme për Zgjerimin (DG Enlargement)
Shef i Njësisë – Njësia D3 "Bashkëpunimi dhe Programet Rajonale"

Personi i kontaktit:
Gerry Renders
Menaxher Programi

Bashkëpunimi dhe Programet Rajonale të Politikave të BE-së

gerry.RENDERS@ec.europa.eu

Paola Albrito
Shefe e Zyrës Rajonale Evropiane

Personi i kontaktit:

Demetrio Innocenti
Oficer i Programit të UNISDR-së

innocenti@un.org

Dimitar Ivanov
Shef i Zyrës Rajonale për Evropën

Personi i kontaktit:

Sara Lappi
Koordinator Projekti
Zyra e Projektit VMO/FMI në Shkup

sari.lappi@fmi.fi

http://www.preventionweb.net/ipadrr/

Ky botim është realizuar me ndihmën e Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e vetme e agjencive zbatuese dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si pasqyrim i pikëpamjeve të Bashkimit Evropian.